



KOLEGJI ILIRIA

Licensuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim
Rruga Gazmend Zajmi Nr. 75 Prishtinë, Tel: +381 (0) 38 233 951 E-mail: info@uiliria.org Web: www.uiliria.org

Në bazë të nenit 17 paragrafi 15 dhe 16 të Statutit të Kolegjit ILIRIA të vitit 2012, Rektorati pranë Kolegjit, me datë 06/09/2016 mori këtë;

V E N D I M PËR ORGANIZIMIN E LIGJËRATAVE DHE USHTRIMEVE NË VITIN AKADEMIK 2016/2017

- I. Aprovohet fillimi i procesit mësimor, përkatësisht fillimi dhe kohëzgjatja e ligjëratave dhe ushtrimeve gjatë vitit akademik 2016/2017 për studentët e regjistruar pranë Kolegjit ILIRIA.
- II. Konstatohet se ligjëratat dhe ushtrimet në këtë vit akademik sipas statutit do të organizohen në dy semestra atë dimëror dhe veror.
- III. Ligjëratat në semestrin dimëror në të gjitha programet, gjatë vitit akademik 2016/2017 të fillojnë më 31 tetor 2016 dhe të përfundojnë më 12 shkurt 2017.
- IV. Nga data 13 shkurt 2017, në periudhë një mujore deri në datë 12 mars 2017 është periudha e pushimit semestral.
- V. Ligjëratat në semestrin veror në të gjitha programet, gjatë vitit akademik 2016/2017 të fillojnë më 13 mars 2017 dhe të përfundojnë më 25 qershor 2017.
- VI. Urdhërohen njësitë akademike sipas kërkesës dhe nevojës së studentëve dhe të dekanatit të njësisë akademike të organizohen edhe ligjëratat dhe ushtrime intenzive shtesë jashtë programit zyrtar të paraparë në bazë të rëndësisë në këto periudha: a) Një javë para afatit të provimeve; b) Dy javët e para të shtatorit c) Në kohëzgjatje prej dy javësh pas përfundimit të semestrit dimëror; d) Dy javë gjatë muajit Korrik.

A r s y e t i m

Bazuar në Statutin e Kolegjit ILIRIA, ligjëratat për një semestër zgjasin 15 javë (3.5 muaj). Kolegji ILIRIA u ofron ligjëratat dhe ushtrime shtesë pa pagesë, sipas kërkesës së studentëve apo konstatimit nga dekanati i njësisë akademike.

Bazuar në Statutin e Kolegjit ILIRIA viti akademik fillon me 01 Tetor dhe përfundon me 30 Shtator. Koha e fillimit të ligjëratave dhe ushtrimeve duhet të organizohet brenda këtij intervali kohor, por jo domosdoshmërisht të përputhet me kohën e fillimit të vitit akademik.

Rektori

